- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimi të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri I Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 613-26-4112-5-2-1/C1219

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10 % e ofertës me vlefshmëri prej 10 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, apo në vlerë prej 22.800.00€
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar - e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 10 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 10 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të kontratës.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë max 10 ditë pas nënshkrimit të kontratës.

	17.2	Përfundimi i të gjitha Punëve do të jetë: 150 ditë, të ndara në dy vite fiskale, 2026-2027, sipas ndarjeve buxhetore të parapara në vitin 2026, janë paraparë mjetet në shumë prej: 210.000.00€, kurse për vitin 2027, shuma e mbetur prej prej 17.000.00€ Data e përfundimit të punëve të parapara me këtë kontratë, nuk duhet të jetë më larg se 30.04.2027. Çdo tejkalimi, ose mosrespektim të KPK dhe KVK, konsiderohet shkelje e afateve kohore për përfundimin e punëve dhe do të ekzekutohen penalet sipas pikës 19.1, të KVK-së.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit Caktohet: 1. Armend Aliu - kryesues 2. Shefkate Dedushi- antëtar 3. Sead Aliu caktohet MDMK
Parimet përgjithshme të pagesave	24	Pagesat do të bëhen sipas situacioneve të përfunduara ne teren dhe të pranuar nga menaxheri i kontratës duke mbajtur 10% nga secila faturë deri sa të arrin shuma 90% e mjeteve të paguara. Pjesa e mbetur për pagesë prej 10% do t'i paguhet kontraktuesit pas leshuarjes se certifikates se perdorimit
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: <i>N/A</i>
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura: kontraktuesi do te sjelle sigurimin e garancionit mbi kualitetin e punimeve 10% te vleres se kontrates per 1 vit apo 12 muaj i cili do te perdoret per permirsim te defekteve, Certifikata do të lëshohet OE sipas nenit 33 të KPK, në formën e publikuar nga ana e KRPP-së, CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOHSHËM të puneve, njëashtu pas përfundimit afatit të kualitetit OE i lëshohet CERTIFIKATË E PRANIMIT PËRFUNDIMTAR , sipas manualit-doracakut të KRPPsë, i publikuar më dt 08.07.2024
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 10 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 10% të vlerës së kontratës ne forme te sigurimit (sigurimi mbi kualitetin e punimeve) ne afat 1 vjeçar apo 12 muaj pas CERTIFIKATË E PRANIMIT TË PËRKOHSHËM
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Ekonomike-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.
--	------	--

Asfaltimi i rrugëve lokale në Fshatrat-Shale,Baic,Resinovc,Poturovc,Medvec,Torine,Lluga,Gllanic					
Vërejtje: Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuara janë të Paralogaritura. Punë kryesi duhet t'ia prezantoj përmes Librit Ndërtimorë në çdo situacion Vlerat Reale Organit Mbikëqyrës për Verifikim dhe Evaluim..Në çmim duhet të përfshihet furnizimi i materialit, instalimi dhe sjellja e produktit në gjendje funksionale. Të gjitha produktet duhet të jenë kualitative dhe ofertuesi në ofertën e tij duhet të përfshij certifikatat e kualitetit dhe të standardeve dhe atestet, matjet e kërkuara me Laborator të licencuar sipas kërkeses së Menaxherit.					
1	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Shalë				
NR. 1	LLOJI I PUNËS	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.1	Pastrimi i terrenit dhe trases nga gjithë sendet dhe inertet etj, dhe vendosja e shenjave që është duke u punuar gjatë ekzekutimit të punimeve, piketimi gjeodezik i rrugëve nëse është e nevojshme definimi parcelave me rrugë.	m'	2300.00	€ 1.00	€ 2,300.00
1.2	Gërmimi i dheut i kategorisë së III, IV dhe V-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi 15km,Dhe ngjeshja me cilindër vibrues deri në arritjen e modulit $M_s=45N/mm^2$. Vërejtje në kuadër të punëve tokësore kalkulohet edhe kanali atmosferik në formë trapezi nëse është i nevojshëm për trajtimin e ujërave atmosferik.	m ³	3680.00	€ 2.00	€ 7,360.00
1.3	Punimi i mbushjes (satbilizues 0-128 mm) t=30 cm me material guror jo koherent me shtrirje në shtresa dhe ngjeshje duhet të arrijnë ngjeshja 50 N/mm ² .	m ³	3680.00	€ 4.00	€ 14,720.00
1.4	Punimi i bankinave me material guror (0-31.5)mm 10 cm.Sasia e llogaritur m ³ në gjendje të	m ³	230.00	€ 9.00	€ 2,070.00

	ngjeshur.				
1.5	Punimi I lëshesave Gypore me diameter Ø 400 mm,ne çmim të përfshihet edhe punimi I kokave sipas detajeve në projekt,me beton te klases C25/30 te deshmuara me ateste. Vëretje ky pozicion aplikohet apo paguhet për punë që janë nevojshme teren.	m'	45.00	€ 4.00	€ 180.00
1.6	Punimi I lëshesave Gypore me diameter Ø 800 mm,ne çmim të përfshihet edhe punimi I kokave sipas detajeve në projekt,me beton te klases C25/30 te deshmuara me ateste. Vëretje ky pozicion aplikohet apo paguhet për punë që janë nevojshme teren.	m'	15.00	€ 5.00	€ 75.00
1.7	Furnizimi me material dhe Punimi I kokave te lëshesave ekzistuse sipas detajeve në projekt,me beton te klases C25/30	copë	20.00	€ 10.00	€ 200.00
1.8	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-63 mm me trashësi t=20cm,matjet duhet te behen me pllake rrethore qdo 50 m' te cilat duhet te arrijne ngjeshjet 60 N/mm2 .	m³	1840.00	€ 15.00	€ 27,600.00
1.9	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=8-13cm,me ngjeshje me cilinder me vibracion,si dhe pas rrafshimit dhe ngjeshjes,duhet te behen matjet te cilat duhet te arrijne ngjeshjet 70 N/mm2-Te deshmuara me ateste ,matjet duhet te behen me pllake rrethore qdo 50 m'	m³	1104.00	€ 17.00	€ 18,768.00
2.0	Demolimi I Asfaltit dhe Kubzave ekzistuese dhe materialeve tjera.	m2	100.00	0.74	€ 74.00

2.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës së asfaltbetonit 0-16mm me trashësi t=7cm në gjendje të ngjeshur. Ne çmim te kalkulohen edhe testet marshall sipas standardeve per ket pozicion. Te sillen atestet e nevojshme.	m²	6900.00	€ 12.00	€ 82,800.00
2.2	Ngritja nivelizimi si dhe pershtatja me nivelin e asfaltin e ri te pusetave ekzistuese. Ne çmim te kalkulohet materiali i nevojshem me pun dhe kapaku nga materiali metalik për peshë 40 ton. Komplet per copë.Vëretje ky pozicion aplikohet apo paguhet për punë që janë nevojshme teren.	copë	30.00	€ 25.00	€ 750.00
2.3	Shërbimet konsultative ,teknike gjatë fazë implementimit projektit si dhe Hartimi i projektit detal nga ana e kompanisë, pas përfundimit të projektit "ASB Draiwing",duke përfshi të gjitha elementet përcjellëse të niveletës situacioni,Detalet, etj.	m'	2300.00	€ 1.00	€ 2,300.00
	Total Asfaltimet ne Fshatin Shalë		Totali me TVSH		€ 159,197.00
3	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Resinovc, Baic				
NR. 1	LLOJI I PUNËS	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1.1	Pastrimi i terrenit dhe trases nga gjithë sendet dhe inertet etj, dhe vendosja e shenjave qe është duke u punuar gjate ekzekutimit te punimeve, piketimi gjeodezik i rrugëve nëse është e nevojshme definimi parcelave me rruge.	m'	150.00	€ 1.00	€ 150.00
1.2	Gërmimi i dheut i kategorisë së III, IV dhe V-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi 15km,Dhe ngjeshja me cilindër vibrues deri ne arritjen e modulit Ms=45N/mm2. Vërejtje në kuadër të punëve tokësore kalkulohet edhe	m³	280.00	€ 2.00	€ 560.00

	kanali atmosferik në formë trapezi nëse është i nevojshëm për trajtimin e ujërave atmosferik.				
1.3	Punimi i mbushjes (satbilizues 0-128 mm) t=30 cm me material guror jo koherent me shtrirje në shtresa dhe ngjeshje duhet të arrijnë ngjeshja 50 N/mm ² .	m ³	280.00	€ 4.00	€ 1,120.00
1.4	Punimi i bankinave me material guror (0-31.5)mm 10 cm.Sasia e llogaritur m ³ në gjendje të ngjeshur.	m ³	15.00	€ 9.00	€ 135.00
1.5	Punimi i lëshesave Gypore me diameter Ø 400 mm,ne çmim të përfshihet edhe punimi i kokave sipas detajeve në projekt,me beton te klases C25/30 te deshmuara me ateste. Vëretje ky pozicion aplikohet apo paguhet për punë që janë nevojshme teren.	m'	50.00	€ 4.00	€ 200.00
1.6	Punimi i lëshesave Gypore me diameter Ø 800 mm,ne çmim të përfshihet edhe punimi i kokave sipas detajeve në projekt,me beton te klases C25/30 te deshmuara me ateste. Vëretje ky pozicion aplikohet apo paguhet për punë që janë nevojshme teren.	m'	10.00	€ 5.00	€ 50.00
1.7	Furnizimi me material dhe Punimi i kokave te lëshesave ekzistuse sipas detajeve në projekt,me beton te klases C25/30	copë	15.00	€ 10.00	€ 150.00
1.8	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-63 mm me trashësi t=20cm,matjet duhet të behen me pllake rrethore qdo 50 m' te cilat duhet të arrijne ngjeshjet 60 N/mm ² .	m ³	150.00	€ 15.00	€ 2,250.00

1.9	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=8-13cm,me ngjeshje me cilindër me vibracion,si dhe pas rrafshimit dhe ngjeshjes,duhet të behen matjet të cilat duhet të arrijnë ngjeshjet 70 N/mm2-Te deshmuara me ateste ,matjet duhet të behen me pllake rrethore qdo 50 m'	m³	80.00	€ 17.00	€ 1,360.00
2.0	Demolimi i Asfaltit dhe Kubzave ekzistuese dhe materialeve tjera.	m2	320.00	0.50	€ 160.00
2.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës së asfaltbetonit 0-16mm me trashësi t=7cm në gjendje të ngjeshur.Ne çmim të kalkulohen edhe testet marshall sipas standardeve për ket pozicion. Te sillen atestet e nevojshme.	m²	520.00	€ 12.00	€ 6,240.00
2.2	Ngritja nivelizimi si dhe pershtatja me nivelin e asfaltin e ri të pusetave ekzistuese. Ne çmim të kalkulohet materiali i nevojshem me pun dhe kapaku nga materiali metalik për peshë 40 ton. Komplet per copë.Vëretje ky pozicion aplikohet apo paguhet për punë që janë nevojshme teren.	copë	5.00	€ 25.00	€ 125.00
2.3	Shërbimet konsultative ,teknike gjatë fazë implementimit projektit si dhe Hartimi i projektit detal nga ana e kompanisë, pas përfundimit të projektit "ASB Draiwng",duke përfshi të gjitha elementet përcjellëse të niveletës situacioni,Detalet, etj.	m'	150.00	€ 1.00	€ 150.00
	Total Asfaltimet ne Fshatin Resinovec		Totali me TVSH		€ 12,650.00
5	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Poturovc Medvec,Torine, Lluga,Gllanic				
NR. 1	LLOJI I PUNËS	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI NJËSI ME TVSH	TOTALI ME TVSH

1.1	Pastrimi i terrenit dhe trases nga gjithë sendet dhe inertet etj, dhe vendosja e shenjave që është duke u punuar gjatë ekzekutimit të punimeve, piketimi gjeodezik i rrugëve nëse është e nevojshme definimi parcelave me rruge.	m'	800.00	€	1.00	€ 800.00
1.2	Gërmimi i dheut i kategorisë së III, IV dhe V-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi 15km, Dhe ngjeshja me cilindër vibrues deri në arrijen e modulit $M_s=45\text{N/mm}^2$. Vërejtje në kuadër të punëve tokësore kalkulohet edhe kanali atmosferik në formë trapezi nëse është i nevojshëm për trajtimin e ujërave atmosferik.	m ³	1280.00	€	2.00	€ 2,560.00
1.3	Punimi i mbushjes (satbilizues 0-128 mm) t=30 cm me material guror jo koherent me shtrirje në shtresa dhe ngjeshje duhet të arrijnë ngjeshja 50 N/mm ² .	m ³	1280.00	€	4.00	€ 5,120.00
1.4	Punimi i bankinave me material guror (0-31.5)mm 10 cm. Sasia e llogaritur m ³ në gjendje të ngjeshur.	m ³	80.00	€	9.00	€ 720.00
1.5	Punimi i lëshesave Gypore me diameter Ø 400 mm, ne çmim të përfshihet edhe punimi i kokave sipas detajeve në projekt, me beton të klases C25/30 të deshmuara me ateste. Vërejtje ky pozicion aplikohet apo paguhet për punë që janë nevojshme teren.	m'	25.00	€	4.00	€ 100.00
1.6	Punimi i lëshesave Gypore me diameter Ø 800 mm, ne çmim të përfshihet edhe punimi i kokave sipas detajeve në projekt, me beton të klases C25/30 të deshmuara me ateste. Vërejtje ky pozicion aplikohet apo paguhet për punë që janë nevojshme teren.	m'	20.00	€	5.00	€ 100.00

1.7	Furnizimi me material dhe Punimi I kokave te leshesave ekzistuese sipas detajeve në projekt, me beton te klases C25/30	copë	15.00	€ 10.00	€ 150.00
1.8	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-63 mm me trashësi t=20cm, matjet duhet te behen me pllake rrethore qdo 50 m' te cilat duhet te arrijne ngjeshjet 60 N/mm2 .	m ³	640.00	€ 15.00	€ 9,600.00
1.9	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=8-13cm, me ngjeshje me cilinder me vibracion, si dhe pas rrafshimit dhe ngjeshjes, duhet te behen matjet te cilat duhet te arrijne ngjeshjet 70 N/mm2-Te deshmuara me ateste ,matjet duhet te behen me pllake rrethore qdo 50 m'	m ³	384.00	€ 17.00	€ 6,528.00
2.0	Demolimi I Asfaltit dhe Kubzave ekzistuese dhe materialeve tjera.	m ²	250.00	0.50	€ 125.00
2.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës së asfaltbetonit 0-16mm me trashësi t=7cm në gjendje të ngjeshur. Ne çmim te kalkulohen edhe testet marshall sipas standardeve per ket pozicion. Te sillen atestet e nevojshme.	m ²	2400.00	€ 12.00	€ 28,800.00
2.2	Ngritja nivelizimi si dhe pershtatja me nivelin e asfaltin e ri te pusetave ekzistuese. Ne çmim te kalkulohet materiali I nevojshem me pun dhe kapaku nga materiali metalik për peshë 40 ton. Komplet per copë. Vëretje ky pozicion aplikohet apo paguhet për punë që janë nevojshme teren.	copë	30.00	€ 25.00	€ 750.00

2.3	Shërbimet konsultative ,teknike gjatë fazë implementimit projektit si dhe Hartimi I projektit detal nga ana e kompanisë, pas përfundimit të projektit "ASB Draiwing",duke përfshi të gjitha elementet përcjellëse të niveletës situacioni,Detalet, etj.	m'	800.00	€ 1.00	€ 800.00
	Total Asfaltimet ne Fshatin ,Medvec,Torine,Lluga,Gllanic.		Totali me TVSH		€ 56,153.00


PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Në rast se projekti gjatë ekzekutimit pëson ndryshime, atëhere pas përfundimit të projektit punëkryesi duhet të hartoj projektin detal të ekzekutuar dhe ta dorëzoj te AK. Preferohet te vizitohet tereni para dorzimit te ofertave.Punet do te kryhen në fshatrat, Shale,Baic,Resinovc,Poturovc,Medvec,Torine,Lluga,Gllanic.

Pos	Përshkrimi Rikapitullim	Vlera me TVSH në €
1	Total Asfaltimet ne Fshatin Shalë	€ 159,197.00
3	Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Resinovc, Baic	€ 12,650.00
4	Total Asfaltimet ne Fshatin ,Medvec,Torine,Lluga,Gllanic.	€ 56,153.00
	TOTALI I PËRGJITHSHËM ME TVSH	€ 228,000.00

Q. Kurrumeli





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. **152425**

Për **KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **Valdrini SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Llot 2 Asfaltimi i rrugicave ne lagjet e fshatrave Shale, Baice, Resinoc, Poturovc, Medvec, Torine, Lluga dhe Gllanice**

Nr. prokurimit: 613-26-4112-5-2-1

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **22,800.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **22,800.00€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 365 ditë kalendarike prej **04.08.2026** deri më **04.08.2027**

Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit të Garancionit, Siguruesit/Garantuesit i kalon e drejta për ta rimbursuar nga i Siguruari/Kontraktuesi shumën e paguar përfituesit, me të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore deri në përbushjen e tërësishme të detyrimeve.

Data lëshimit: 04.08.2026

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (URDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë: 04.08.2026

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimi Publik në Republikën e Kosovës, Rregullores Nr.001/2022, Për Prokurim Publik, Versioni i konsoliduar 11.11.2024, dhe Udhëzuesit 002 2024 për plotësim ndryshim të Udhëzuesit 001 2023 për prokurimin Publik nxjerrë:


V E N D I M

Caktohet Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësit i realizimit të kontratës për kontratën me titullin : **Llot 2 Asfaltimi i rrugicave ne lagjet e fshatrave Shale, Baice, Resinoc, Poturovc, Medvec, Torine, Lluga dhe Gllanice me numër identifikues: 613-26-4112-5-2-1**

1. Armend Aliu, Drejtoria për Infrastrukturë, caktohet menaxher i kontratës udheheqës.
2. Shefkate Dedushi, Drejtoria për Infrastrukturë, caktohet menaxher i kontratës udheheqës
3. Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë për realizimin e kontratës sipas pikës 1 dhe të këtij vendimi caktohet:
 - a) Sead Aliu, Drejtoria për Infrastrukturë;
4. Menaxheri i kontratës, obligohet që të hartoj një Plan të Menaxhimit të Kontratës, duke përdorur formularin Standard të miratuar nga KRPP, i cili duhet të nënshkruhet nga ana e të dy palëve (Menaxherit të kontratës se AK dhe Menaxherit të Kontratës se OE) në sistem të E-Prokurimit, brenda 5 ditësh pas nënshkrimit të kontratës, para inicimit të zbatimit të kontratës dhe një kopje të nënshkruar të planit për menaxhimin e kontratës do ta përcjelle tek departamenti i prokurimit.
5. Menaxheri i kontratës e menaxhon kontratën deri në pranimin e plotë të [artikujve/shërbime/punëve] të kërkuar respektivisht deri në përmbylljen e kontratës.
6. Përgjegjësitë dhe funksionet e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejtë për menaxhim të kontratës janë:
 - a) Monitorimin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, dhe
 - b) Rishikimin, aprovimin dhe procesimin e vlerësimit të përfundimit të kontraktuesit – vlerësime të propozuar nga menaxherët e kontratave nën mbikqyrjen e tij.
7. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kopje: Menaxherit të projektit;
Mbikëqyrësit/ve të kontratës;
Departamentit të Prokurimit;

Zyrtari Kryesor Administrativ
Imri Ahmet



KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 613-26-4112-5-2-1/C1218

Kuvendi Komunal Lipjan të cilën e përfaqëson, **Drejtori i Drejtorisë së Prokurimit në Lipjan z. Bekim Shabani** në njërën anë (në tekstin e mëtejshëm) Autoriteti Kontraktues; dhe

K.N.P.SH. PAPENBURG & ADRIANI COMPANY SH.P.K., Grackë e Vjetër, Magjistrale M- 25 Ibrahim Rugova , Pn, Lipjan, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë të shënuara me poshtë:

Llot 1 Asfaltimi i rrugicave Hallaq i Madh, Mirene dhe Kraishtë me numër identifikues: 613-26-4112-5-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

Llot 1 Asfaltimi i rrugicave Hallaq i Madh, Mirene dhe Kraishtë, Ky projekt ka të bëjë me Piketimin e projektit, germim, mbushje asfaltim me specifikisht të gjitha janë të përfshira në paramasën e këtij projekti.

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **189,173.00 €**; [*njëqind e tetdhjetë e nëntmijë e njëqind e shtatdhjetë e tri euro e zero cent*] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të ceken titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.





¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Kontraktuesin

Emri:	Bekim Shabani	Emri:	Fatmir Dervishi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit	Pozita:	Inxhinier
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	03.08.2026	Data:	03.08.2026
Vula:		Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 613-26-4112-5-2-1/C1218

Neni 1

Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuoruar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

